



Delës-Izlazna

Nr. 1-11
Br.

Data 21.01.2022
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.23.12.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Lendita Bektashi Memishi (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fatmir Bërbatovci (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Slobodan Jakovljevic (S(SL)L) dhe Katarina Adjancic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, përf. e KFOR-it zvicran, përf. i IZHL-së dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtari më i vjetër i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit komunal
3. Shpallja-Publikimi i pronave komunale për dhënien në shfrytëzim
4. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa
5. Formimi i Komisionit komunal të Aksionarëve të NPL-“kastrioti” SH.A.
6. Të ndryshme

Enver Gashi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës duke theksuar se në pikën “Të ndryshme” do të jetë zgjedhja e Nënkyetarit për komunitete dhe formimi i Komitetit për komunitete.

Ajet Berisha – Nga praktikat e mëhershme të seancave ku zgjedhet kryesuesi i Kuvendit dhe organet obligative, që janë 2 Komitetet, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për komunitete, do të thotë se janë seanca të veçanta në të cilat nuk trajtohen pikat tjera të rendit të ditës. Këtë, po e mbështesë edhe në aspektin ligjor sepse LVL-ja, i njehë këto organe obligative për funksionim normal të Kuvendit komunal. Duke u bazuar se edhe zgjedhja e kryesuesit dhe Komiteteve kërkojnë që MAPL-ja, të bëjë shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre organeve, mendoj se çdo pikë tjetër e rendit të ditës në këtë seancë është e pavlefshme dhe duhet të largohet. Duke pasur për bazë këto elemente që i thashë dhe bazuar edhe në Rregulloren e punës së Kuvendit, anëtarët e Kuvendit është dashur të pajisen me elementet bazike si LVL-në, Ligjin mi financat publike, Ligjin për kufijtë e Komunave, Statutin e Komunës dhe elementet tjera, që minimalisht me ditë rolin të cilin e kanë anëtarët e Kuvendit komunal. Në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, nenit 31, dhe nenit 3, mendoj se të gjitha vendimet e rëndësishme edhe strategjike siç është shpallja e pronave, apo formimi i Komisionit të Aksionarëve duhet të kaloj përmes KPF-së. Prandaj, duke i pasë për bazë të gjitha këto mendoj se këto 2 pika të rendit të ditës, duhet të largohen.

Enver Gashi - E hudhi në votim rendin e ditës të cekur më lartë.

Miratohet rendi i ditës me 13 vota për dhe me 7 vota kundër.

Pika 1 rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit ishin të pranishëm në mbledhje.

Pika 2 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ne si subjekt i iniciativës qytetare për Obiliq, propozojmë znj.Vlora Mjekiqi Kabashi për kryesuese të Kuvendit komunal.

Ajshe Haliti Pllana – Ne për kryesues të Kuvendit komunal propozojmë z.Sami Ahmeti.

Enver Gashi – Ne duhet ta formojmë një Komision për verifikim të votave për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit dhe një Komision tjetër për numrim të votave dhe propozojmë që Komisionet të përbëhen nga 3 anëtarë.

Të gjithë të pranishmit u pajtuan njëzërit që të 2 Komisionet të përbëhen prej 3 anëtarëve.

Enver Gashi – Ne për anëtarë në Komisionin e verifikimit propozojmë z.Shaip Paloja.

Sami Ahmeti – Propozon z. Valon Svirca, për anëtarë të Komisionit.

Ajet Berisha – Propozon znj.Valbonë Beka, anëtare e Komisionit të verifikimit.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht u pajtuan që të formohet Komisioni për verifikim të votave për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit komunal me këtë përbërje: Shaip Paloja, Valon Svirca dhe Valbonë Beka.

Enver Gashi – Ne për anëtar në Komisionin për numrim të votave propozojmë z.Fatmir Bërbatovci.

Albanë Shillova Shalaku – Propozon znj.Ajshe Haliti Pllana, anëtare e Komisionit.

Linda Sadiku – Propozon z.Bajram Hashani, anëtar i Komisionit.

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht u pajtuan që të formohet Komisioni për numrim të votave për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit komunal me këtë përbërje: Fatmir Bërbatovci, Ajshe Haliti Pllana dhe Bajram Hashani.

Pasi që Komisioni i verifikimit konstaton se gjithçka është në rregullë fillon votimi i fshehtë i secilit anëtarë veç e veç të Kuvendit komunal për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit komunal.

Pas përfundimit të votimit dhe pas numrimit të votave nga Komisioni, anëtarë më i vjetër i Kuvendit komunal konstaton se me 12 vota për 8 vota kundër dhe 1 votë abstenim zgjedhet znj.Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Kuvendit komunal.

Pastaj znj.Vlora Mjekiqi Kabashi i falenderoi të gjithë për besimin e dhënë dhe nga ky moment udhëheqë mbledhjen e Kuvendit komunal.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet Propozimvendimin për shpalljen-publikimin e pronave komunale për dhënien në shfrytëzim.

Sami Ahmeti – Kryesuese, shfrytëzoi rastin të ju uroj për pozitën e re dhe siç po duket partnerët e koalicionit ju nxorën nga kriza qysh në fillim. Unë shpresoj në një bashkëpunim korrekt edhe pse në këtë dyshoj. Pasi që është fjalimi i parë në Kuvendin komunal, shfrytëzoi rastin të falenderoj qytetarët e Komunës së Obiliqit për mbështetjen që na dhanë, posaçërisht falenderoj veteranët e UÇK-së, së Kosovës, që na qëndruan afër. Po ashtu, dua të uroj të gjithë kolegëve të Asamblesë për mandatin e fituar nga qytetarët në zotimet dhe angazhimet për të mirën e përgjithshme. Do të doja që në mesin tonë të mos ketë asambleistë që blen votat apo e fituan mandatin në ndonjë formë tjetër abuzive. Të nderuar kolegë, kjo tema e pronave publike ka qenë aktualitet që nga fillimi i mandatit të parë, e kryesisht në mandatin e dytë të kësaj strukturë politike. Sot në mbledhjen e parë kemi para vetes një listë me 198 prona, që Komuna jonë respektivisht Kryetari i saj shpallin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë. Kjo shpallje është në kundërshtim me LVL-në, neni 52, pika 5 dhe 2.2, për arsye se bëhet ende pa u formuar KPF-ja, që do të duhej të ishte trupi konsultativ vendimmarrës në këtë fushë. Po ashtu, këto prona po shpallen për dhënien në shfrytëzim pa pasur kurrfarë plani urbanistik që e orienton zhvillimin e një fushe, apo aktiviteti në të mirë të të përgjithshmes. Të nderuar kolegë, ne jemi dëshmitarë të dhënies së pronave të shumta nga ky Kuvend, madje edhe të marrjes së tyre nga vetë funksionarët e lartë të këtij institucioni me pretendimin e zhvillimit të Komunës dhe rritjen e numrit të të punësuarve, por gjendja në terren është shumë më ndryshe. Rrjedhimisht

lindin pyetjet sa u rritën investimet, apo të hyrat komunale nga këta të ashtuquajtur investitorë, sa persona nga Komuna jonë u punësuan si rezultat i dhënies së këtyre pronave, çfarë zhvillimi apo atraksioni ka Komuna jonë nga këto dhënie, apo marrje të këtyre pronave, apo a po ndotet edhe më tej Komuna jonë nga investimet dhe investitorët siç është rasti në të paktën në 4 zona, apo në vendbanime me gurëthyes, fabrika të tjegullave, betonjere e bazë të asfaltit, a po rrezikohet humbja e tokës bujqësore edhe pyjeve siç ishin listuar disa zona në Breznicë e Kozaricë. Po ashtu, a kanë lokalitetet e caktuara të gjithë infrastrukturën e duhur që ta kemi lluksin që pronën publike ta vënë te profiterët kur dihet që ka shumë nevoja psh banorët e Breznicës, pikërisht të Shegëza edhe në debate publike kanë kërkuar hapësira, apo parcelë për varreza të fshatit, apo a po i respektojnë të ashtuquajturit investitorë rregullat apo kushtet e marrjes së pronave, a po merren masa ndaj atyre që nuk po i respektojnë këto kushte dhe nëse, po na tregoni një ose dy prej tyre. Përgjegjet e këtyre pyetjeve ne dhe shumë qytetarë i dijmë se janë negative, por grupi parlamentar i LVV-së, do të bashkëpunoj me anëtarët e ndershëm të këtij Kuvendi që mendojnë për të mirën e qytetarëve dhe shpresoj se ka mjaft të tillë si nga opozita, ashtu edhe nga pozita që vendimet kuturu si ky i sotit të mos i kalojnë për prona publike, në mënyrë që prona publike të vazhdoj të ruhet më shumë se sa prona private sepse është më e vlefshme, sepse është e të gjithëve, e jo vetëm e një individi, apo i një grup individësh. Ne e dijmë se janë bërë shumë premtime, apo pazare të cilat me nguti ka filluar ti zbatoj kjo qeverisje, por deri sa kemi instanca tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që e mbikqyrin këtë Kuvend, jam i sigurtë se vendimet e tilla nuk do të aprovohen asnjëherë. Të nderuar kolegë, unë dua të theksoj se LVV-ja, nuk është kundër investitorëve dhe ne jemi që në Komunën tonë pse jo edhe pronën publike ta jepim në shfrytëzim te investitorët e singertë që investimet e tyre i kthejnë në të mirën e qytetarëve tonë, që në Komunën tonë të ketë prodhim e zhvillim, pse jo edhe aktivitete të ndryshme, vetëm jo të tilla ku rrezikohet dhe humbet jeta e qytetarëve. Grupi parlamentar i LVV-së, në Obiliq jemi dhe do të jemi gjithnjë kundër tendencës apo përpjekjes të keqpërdorimit të pronës publike, apo çfarëdo vendimi tjetër që dëmton interesat e qytetarëve tonë. Grupi parlamentar i LV-së në Obiliq konsideron se shpallja e kësaj liste të pronave për dhënien në shfrytëzim po bëhet pa ndonjë planifikim, pa pasë plan urbanistik si dhe duke anashkaluar KPF-në, i cili ende nuk është formuar. Prandaj, këto prona po shpallen që të sigurohen investitorët e fushatës zgjedhore si dhe bashkëpunëtorët e ndryshëm që punojnë për interesa të veta, që në vitin e ardhshëm të mund të kompensohen me prona të shtetit për kontributin e tyre ndaj një subjekti politik. Ne do të votojmë kundër, madje qysh sot do ti dërojmë vërejtjet tona në MAPL.

Ajet Berisha – Praktikisht edhe pse po iu duket problem i thjeshtë, apo teknik unë mendoj se procesi i zgjedhjes së kryesueses do të përsëritet prapë sepse keni bërë shkelje procedurale. Unë mund të them se sipas nenit 16 të Rregullores së Kuvendit komunal, që është në fuqi lista e fletëvotimit për zgjedhjen e kryesueses së Kuvendit përpilohet sipas renditjes alfabetike të emrave të kandidatëve, që do të thotë se në këtë rrafsh sado që duket e thjeshtë dhe teknike, është shkelje dhe mendoj se zgjedhja e kryesueses së Kuvendit komunal do të përsëritet në mbledhjen e radhës. Sa i përket rendit të ditës në kuptimin e fjalës të dhënies së pronave dhe duke pasë për bazë këtë që e thashë më heret sepse për me nxjerrë vendime Kuvendi komunal, duhet fillimisht që vendimet të cilat janë strategjike buxhetore në interes të Komunës, të kalojnë përmes KPF-së. Në rastin konkret këtë Komitet nuk e kemi të zgjedhur ende, por edhe për më keq mendoj se vendimi për zgjedhjen e kryesueses duhet ti kaloj MAPL-së, verifikimit të procedurës dhe ligjshmërisë. Proces i zgjedhjes së kryesueses do të përsëritet dhe unë mendoj se marrja e vendimeve tjera nga ky Kuvend është në kundërshtim me rregullat e funksionimit normal të Kuvendit komunal. Shpallja e këtyre listave është në kundërshtim në aspekte tjera ligjore që i thotë vetë ligji për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe Rregullorja që e përcakton më saktë këtë gjë. Këtë e argumentoj përmes neneve të përcaktuara në kapitullin 2 neni 5, pika 1.2, që thotë qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të jetë i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor. Unë në bazë të informatave që i kam Komuna e Obiliqit, nuk ka një plan zhvillimor hapësinor të miratuar nga ky Kuvend sepse kanë provue 2,3 herë dhe ka dështue për aspekte teknike, ligjore etj. Prandaj, ju në asnjë formë nuk mund të thirreni në planin zhvillimor

që parashehë dhënien e këtyre pronave, e sidomos dhënien e pronave në Breznicë, mbi 200 ha sa keni planifikue, do të thotë nuk janë të planifikuara në planin zhvillimor, mungojnë dokumentet bazike në çka ju duhet me u thirrë. Në listat që i keni ofrue sipas Rregullores, procedura paraprake e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, pika 2, thotë: “Listat e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajnë këto të dhëna, të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës”. Në këtë përbërje të të dhënave që duhet ti përmbaj lista ju destinimin nuk e keni ofrue, që edhe kjo është një shkelje e asaj që kërkon Rregullorja dhe ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Për miratimin e kësaj pike janë 2 probleme, e para nuk kemi konstituim të organeve komunale që mundësojnë funksionimin normal të Kuvendit dhe e dyta në bazë të procedurave që parashehë ligji për dhënien në shfrytëzim dhe Rregullorja që e përcakton saktë, do të thotë në të 2 pikat ju bëni shkelje sepse nuk ka plan zhvillimor hapësinor të miratuar në Kuvendin komunal. Do të thotë nuk kemi ku me u thirrë dhe destinimin për çka po jepet dhe e dyta edhe vetë lista që e keni ofrue nuk keni dhënë asnjë destinim se për çfarë qëllimi këto prona jepen, cili është interesi i qytetarëve dhe Komunës, që ju këto prona ti jepni në shfrytëzim. Këto, janë probleme që ne do ti adresojmë në Ministrinë përgjegjëse për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe mendoj se edhe për kryesuesen, por edhe edhe për këtë pikë do të kthehet në pikën 0.

Shaip Paloja – Ju lus, kryesuese që në të ardhmen mos lejo diskutime jashtë rendit të ditës sikurse parafolësi i mëhershëm i nderuari z.Sami Ahmeti, i cili e keqpërdori këtë foltore duke i thënë Iniciativës qytetare se e keni kryer punën me kualicionin dhe unë mund ta marrë me mend se për kend e ka fjalën. IQO-ja, ka kualicionin vetëm me qytetarin e Obiliqit dhe kjo ka dëshmue në zgjedhjet e kaluara, fushata ka përfundue dhe tani ne duhet ti qasemi punës. Dëshmia më e mirë është se Kryetari i Komunës, ka fituar mbi 65 % të votave të qytetarit të Obiliqit. Ndërsa, asambleistët e IQO-së kanë arritë një rekord që nuk mbahet mend mbi 42 %, ose 43 % e përbëjnë Kuvendin komunal. Kjo është votë e qytetarit dhe nuk është mirë të nënçmohet qytetari i Obiliqit. Nëse, kolegu ka dëshmi se dikush ka ble vota është Prokuroria, procedoje çështjen në gjyq sepse këtu nuk jemi Gjykatë. Mendoj se ndarja e asambleistëve në të ndershëm dhe të pandershëm nuk i ka hije hiç sepse ne të gjithë këtu jemi të ndershëm dhe të gjithë e kemi marrë besimin e dikujt. Sa i përket zonave të shpallura për dhënien në shfrytëzim, zonat nuk po i jepen askujt sot, por ne po nxjerrim një vendim që këto zona në të ardhmen të shqyrtohen dhe të jepen me vendim.

Sami Ahmeti – Sa i përket z.Shaip Paloja, atë që e tha realisht unë nuk e marrë seriozisht z.Shaip, sepse në gjuhën e popullit ky e ka një emër. Mirëpo, sido që të jetë blerja e votave unë nuk e thashë, por thashë nëse ka persona që kanë blerë votën, e më duket se ky e ka pasë mizën pas veshit. Ndërsa, te pronat që do të jepen dhe qysh jepen ne e dijmë shumë mirë se çka thotë ligji, duhet 1 vit kalendarik të shpallen paraprakisht në mënyrë që në vitin e ardhshëm me mund me i krye zotimet që ju i keni dhënë. Sa i përket kualicionit tashmë dihet se kryesuesja fitoi pozitën me votat e listës serbe.

Kryetari – Fillimisht i uroj kryesueses postin e ri dhe të gjithë asambleistëve mandatin e ri. Unë kur e dëgjova z.Ahmeti në fjalimin e tij që dikush ia ka përgatitë mendova se po e përmbyllë me një përfundim, por në fund e tha se ne jemi për investitorët mirëpo, duhet të ua japim pronën investitorëve të ndershëm. Mendoj se më së paku z.Sami Ahmeti, ka të drejtë ti përzgjedhë se kush janë të ndershëm e kush janë të pandershëm. Z.Ahmeti, të paktën vlerat e mia që kam qenë në luftë ti nuk mund ti mbrosh sepse e din pse nuk je më në kolegji.

Sami Ahmeti – Sa i përket asaj se a mi ka përgatitë dikush, apo jo, kjo ty nuk të intereson fare sepse ne jemi një subjekt politik serioz që gjërat i përgatitim bashkë dhe vendimet nuk i marrim në kafe të rakisë. Ndërsa, vlerat e luftës tashmë po duket dhe ju uroj suksese.

Kryetari – Vlerat e mia të luftës nuk mund ti mbrosh, edhe unë jam UÇK, por ti tregoj kolegëve tuaj dhe qytetarëve pse nuk je më në kolegji.

Sami Ahmeti – Ajo është jashtë interesave të qytetarëve dhe të këtij Kuvendi dhe kurdo që juve, ju intereson ne mund të marrim një dokument prej kolegjit pse nuk jam në kolegji. Unë nuk jam më në kolegji

sepse punën time nuk dua me ma nënvlerësue askush, vetëm për faktin se nuk jam paguar aq sa e kam eksperiencën e punës time. Prandaj, mos u merrë me punët tjera sepse qytetarëve nuk iu interesojnë. Unë e di se ju keni prirje që të merreni me thashetheme të kafeve, por bëni punën tënde e përcjellni tjerët.

Kryesuesja – I nderuar z.Sami Ahmeti, ju lutem të keni kujdes për fjalorin që po e përdorni.

Shaip Paloja – Unë dua ti tregoj z.Sami, se vërtetë unë e kam një emër dhe qytetari i Obiliqit, mua më njuhë shumë mirë dhe familjen time. Unë e kam një trung dhe një rrënjë shumë të fortë prej të parëve të Obiliqit dhe Samiu ka jetuar në Dumnicë, nuk e din sepse nuk ka jetuar fare në Komunë të Obiliqit. Unë e di qysh ka jetuar z.Sami dhe kush është z.Sami.

Labinot Mirena – Fillimisht i uroj kryesueses postin e ri dhe mendoj se Obiliqi ka pasë sukses dhe është dëshmuar edhe me zgjedhjen e kryesueses, prandaj i uroj punë të mbarë dhe suksese. Sa i përket grupit parlamentar të LVV-së, unë vetëm e kam një kërkesë për juve, që ta kryejmë mbledhjen sa më shpejtë se mos po ndalet agregati sepse po e shohim që na kanë kthyer në vitin 2000.

Ajet Berisha – Mendoj se puna e kolegjit, puna e trungut familjar konsideroj se edhe z.Shaip, Kryetarit e secilit prej neve na interesojnë procedurat me të cilat po merremi. Unë e lus kryesuesen që pyetjet e tilla Kryetarit të ia ndaloj sepse nuk ka nevojë këtu, me i shantazhë anëtarët e Kuvendit se ku ke qenë, pse ke qenë. Nëse, ka diçka Kryetari dhe secili prej neve i kemi institucionet ku mund ti adresojmë ç është. Unë pres prej z.Shap, para se me na tregue trungun familjar me na tregue aspektin procedural të shpalljes së këtyre zonave për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Në thelb është dashur edhe Kryetari dhe të tjerët me kontribue rreth pikës së rendit të ditës, ndërsa çka më hyn në punë mua pse ka dalë z.Sami prej një kolegji dhe a punon në një kolegji tjetër, sikurse edhe z.Shaip, a punon në KEK, a është anëtarë i Kuvendit. Unë nuk shantazhohem pse Kryetari e paska një informatë se unë kam mund me bë një gabim dikund sepse Kryetari dhe qeverisja e tij ka lëndë në Prokurori dhe nuk po shantazhohet.

Kryesuesja – Emri yt këtu nuk u përmendë nga asnjëri.

Kryetari – Meqë, më apostrofoi dua ti tregoj z.Ajet se ne jemi matë, populli na ka matë dhe unë i kam 6,500 vota, ndërsa ti i ke gati 1,000 vota. Unë nuk e kam qëllimin me të shantazhu, nuk jemi të vegjël asnjë dhe ne jemi këtu përfaqësues të qytetarëve. Mandatin ti nuk ma ke dhënë, por jam edhe Kryetar i joti dhe nuk e kam qëllimin me të shantazhë. Të keni kujdes mbledhni letrat se në fund z.Ajet i bën telashe policinë duke i dërgue, kujdes letra mos leni nëpër tavolina.

Ajet Berisha – Unë i kam letrat e mia dhe s'kam nevojë me ua marrë përveç aty ku kërkoj sipas qasjes zyrtare e keni obligim, përndryshe krejtë çka i kam për 4 vite Prokurorisë dhe Policisë kam me ia dërgue nëse, konsideroj se është për ata.

Kryetari – Të gjitha dërgoji, bile unë të preferoj me aplkue ndoshta të pranojnë në punë atje.

Ajet Berisha – Faleminderit. Unë juve ju siguroj sikurse edhe më heret edhe tash aspektet ligjore nëse, i cënoni dhe unë i shohë ato lëndë do të iu shkojnë atyre që janë përgjegjës. Kështu veprohet, e jo me u përpjekë me i shantazhë sepse nuk mundesh me na shantazhë hiç. Ndërsa, për qe i ke marrë votat e dijmë zyrtarisht kjo është shpallë, urime vazhdo punën.

Kryetari – Faleminderit, do të vazhdoj punën time bashkë me qytetarë, por me ju shantazhë nuk ju shantazhohj.

Ajet Berisha – Kjo, po shihet sa konsultimin publik e ke bërë për dhënien e këtyre pronave, që po e bën shpalljen.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 9 vota kundër e aprovuan Propozimvendimin nr.-II-1497, të dt.16.12.2021, për Shpalljen – Publikimin në faqen zyrtare të Komunës të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës për dhënien në shfrytëzim dhe Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite për vitin vijues.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.05//2020, për procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, ky Komitet duhet të jetë i përbërë prej 7 anëtarëve. Ne kemi menduar që 3 anëtarë duhet të jenë nga IQO-ja, 2 anëtarë nga LVV-ja dhe 1 anëtarë nga LDK-ja. Po ashtu, ju njoftoj se kemi një kërkesë nga zyrtarja për barazi gjinore për respektimin e Ligjit për barazi gjinore me rastin e formimit të KPF/së.

Enver Gashi – Propozon z.Labinot Mirena, z.Enver Gashi dhe znj.Nazlije Shala. për anëtarë të KPF.së.

Ajet Berisha – Në bazë të Udhëzimit Administrativ, mendoj se kam të drejtë me reague dhe në bazë të një shkresë që ia dorëzova pak më heret kryesueses.

Enver Gashi - Njëherë emrat duhet me i dhënë.

Ajet Berisha – Emrat mundesh menjëherë me i dhënë, por ajo as që e ngriti çështjen për debat.për shkak të ndarjes së numrave. Në bazë të Udhëzimit pikërisht që e lexuat ju neni 6, thotë: “Komiteti për Politikë dhe Financa përbërhet nga përfaqësues të subjekteve politike që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës. Përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e etnive politike si dhe numrin e ulësve nga etnitetet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës”. Praktikisht me propozimin e juaj kryesuese, ju eliminuat grupin e 3 parlamentar që është LB dhe AAK, që para fillimit të mbledhjes ia dorëzova shkresën kryesuesit. Mirëpo, eliminuat edhe etnitetet tjera siç është PDK-ja. Meqë, ka mundësi me u përfshi mendoj se edhe në këtë rast nuk është e juaja me përcaktue se cili juve ju konvenon me qenë në KPF, por duhet të zbatoni urdhëresën. Rasti konkret grupi LB dhe AAK është grupi i tretë për nga madhësia dhe unë nuk them me eliminue absolut as LDK-në sepse edhe LDK/ja dhe PDK-ja, në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ kanë mundësi të jenë pjesë e KPF/së.

Enver Gashi – Të nderuar, ju sot mua ma dërguat formimin e grupit parlamentar që e keni bërë me AAK-në dhe juve ju uroj sukses, por sot ne të gjitha shkresat i kemi bërë si LB dhe AAK. Unë mund të them se që nga mbledhja e ardhshme jeni grup parlamentar ndërsa, sot vetëm e keni sjellë një shkresë.

Ajet Berisha - Në momentin që unë e sjellë shkresën grupi ekziston dhe absolut nuk jam kundër që mos të jetë LDK-ja, patjetër, por mendoj se ka hapësirë në KPF në bazë të Udhëzimit Administrativ, që thotë se sipas mundësive të përfshihen të gjitha etnitetet politike që e përbëjnë Kuvendin komunal. Pra, ka mundësi të përfshihet tash nuk po them të dyjat por LB dhe AAK si një dhe PDK-ja, kështu që është mundësia për me u zbatue Udhëzimi Administrativ.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi për atë që të ketë sa më shumë gjithëpërfshirje, sidoqoftë nga LVV-ja, jam unë Sami Ahmeti dhe Ajshe Haliti Pllana.

Bajram Hashani – Propozon znj.Linda Sadiku, për anëtare të KPF-së.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për, 3 vota kundër dhe 1 votë abstenim morën Vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me këta anëtarë: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashii, Labinot Mirena, Nazlije Shala, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana dhe Linda Sadiku.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja– Ne e kemi edhe çështjen e formimit të Komisionit komunal të aksionarëve NLP “Kastrioti” SH.A. Pas formimit të NLP “Kastrioti” SH.A. ne duhet ta formojmë një Komision mbikqyrës të kompanisë që do të mbikqyrë punën e vazhdueshme, veprimtarinë dhe gjithçka që ka të bëjë me këtë ndërmarrje. Në këtë Komision duhet të jenë 3 anëtarë, ku 2 nga ata duhet të jenë anëtarë të Kuvendit komunal dhe 1 anëtarë nga Ekzekutivi.

Enver Gashi – Propozon z.Jeton Mjekiqi dhe Shaip Paloja për anëtarë të Komisionit.

Kryetari – Propozon znj.Fitore Hashani, anëtare të Komisionit.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 9 vota kundër e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve NLP Kastrioti SH.A. me këta anëtarë: Fitore Hashani, Shaip Paloja dhe Jeton Mjekiqi.

Pika e 6 e rendit të ditës

Vlora Mjekiqi Kabashi – Po ashtu, e kemi edhe zgjedhjen e Nënkrjetarit për komunitete dhe me këtë rast fjalën ia kaloj Kryetarit të Komunës.

Kryetari – Duke punuar në vazhdimësi dhe duke pasë parasysh se komuniteti serbë është një prej komuniteteve më të mëdha joshqiptare në Komunën tonë, ne do të vazhdojmë me propozimin për z.Slavisa Jakovljevic, Nënkrjetar për komunitete.

Sami Ahmeti – Edhe për pikën paraprake është mirë, e jo me i kalue pikat pa bashkëbisedue me anëtarë të Kuvendit sepse ne jemi subjekte politike dhe nuk mundet vetëm pozita me bë mbikqyrjen e një kompanie apo diçka të tillë. Sido që të jetë janë ligjet që do të shikohen dhe do të merren vendime. Sa i përket Nënkrjetarit për komunitete, Kryetari tha që me traditë ka vazhdue kështu dhe po vazhdojmë ne me emërimet, ose me lënien e një pozite për komunitete. Mirëpo, sipas ligjit dhe regjistrimit të fundit të popullsisë që është bërë në vitin 2011, në Komunën e Obiliqit nuk është e plotësuar kuota 10 % e pakicave, që do të jepte mundësinë e zgjedhjes së Nënkrjetarit për komunitete. Megjithatë Kryetari vendos vetë, ndërsa ne do të vazhdojmë me anën ligjore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 9 vota kundër e aprovuan Vendimin për zgjedhjen e z.Slavisa Jakovljevic, Nënkrjetar për komunitete.

Kryesuesja – Ne e kemi edhe formimin e Komitetit për komunitete, i cili duhet ti ketë 9 anëtarë, ku 3 prej tyre duhet të jenë nga Kuvendi komunal, ndërsa tjerët zgjedhen sipas shpalljes publike. Në këtë Komitet propozoj që 1 anëtar të jetë nga IQO-ja dhe 2 anëtarë nga lista serbe.

Ajet Berisha – Unë po çuditem me propozimin tuaj, pse 2 anëtarë të listës serbe. Pjesa tjetër që zgjedhet jashtë Kuvendit mund të jetë më shumë nga komunitetet ndërsa, edhe ky Komitet duhet të përbëhet nga subjektet e ndryshme që janë 1 nga lista serbe dhe radhën e ka LB e AAK me pasë, prandaj propozoj të jetë Xhelal Krasniqi, anëtar në këtë Komitet.

Enver Gashi – Propozon z.Lulzim Preniqi, anëtar të Komitetit për komunitete.

Slobodan Jakovljevic – Propozon znj.Katarina Adjancic, anëtare të Komitetit.

Katarina Adjancic – Propozon z.Slobodan Jakovljevic, anëtar të Komitetit.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 9 vota kundër e aprovuan Vedimin për formimin e Komitetit për komunitete me këta anëtarë: Lulzim Preniqi, Katarina Adjancic dhe Slobodan Jakovljevic.

Ajet Berisha– Duke pasë për bazë gjendjen momentale me energji elektrike, konsideroj se më tepër se sa me i zbatue ligjet dhe vendimet që kjo Komunë ka nxjerrë dhe nga aspekti i Ligjit të Obiliqit, që i siguron 24 orë energji elektrike për Komunën tonë janë edhe disa vendime që i kemi bërë në një periudhë kur kemi bashkëpunue me KEDS-KESCO, që obligohet KESCO 24 orë me furnizue Komunën e Obiliqit. Atëherë ishin me grupe, që ishte grupi A, që në atë grup futen emergjencat, institucionet më të rëndësishme të shtetit dhe Komuna e Obiliqit. Duke pasë për bazë këto vendime dhe Ligjin e Obiliqit, konsideroj se Kryetari i Komunës më shumë se sa të merret me hetimet për neve se kush

çfarë probleme kemi është dashur të angazhohet që të zbatohet kjo pikë e Ligjit të Obiliqit dhe e vendimit apo nënshkrimit që e ka bërë ky me KEDS-KESCO, për furnizim 24 orë të Komunës së Obiliqit me energji elektrike.

Kryetari – Ju njoftoj se sot në takimin e mëngjezit e kemi diskutue këtë

çështje me Drejtorinë e ambientit dhe reagimin ia kemi dërguar KEDS-it. Po ashtu, kërkojmë nga qytetarët që të gjitha dëmet në aspektet biznesore dhe në amvisni që janë shkaktuar për këtë ndërprerje të rrymës të adresohen në Gjykatë sepse qytetarët kanë të drejtë. Ligjet dhe Rregulloret nuk i ka nxjerrë ky Kuvend z.Ajet, por Parlamenti i shtetit dhe ne i implementojmë. Ne do të bëjmë gjithçka që është e mundshme në shërbim të qytetarëve sepse jemi të zgjedhur nga qytetarët.

Ajet Berisha – Unë nuk thashë se ky Kuvend i ka nxjerrë ligjet se ligjet e di kush i nxjerrë ndërsa, Rregullore ne mund të nxjerrim dhe vendime, por ligje jo fatbardhësisht se e kishim marrë në qafë këtë vend, e shqyr që nuk nxjerrim ligje. Në thelb unë kërkoja angazhim se dëmet që po u bëhen qytetarëve

janë të mbrojtura me ligj, do të thotë ka njerëz që kanë menduar më heret për këto punë dhe e kanë ditë se mund të vijmë në situata të tilla dhe kemi qenë në një periudhë më të rëndë se kaq. Pra, minimalisht duhet të mbrohet kjo e drejtë me ligj dhe kjo e drejtë është e përcaktuar, e mbrojtur dhe detyrohet secila kompani që bën furnizim me energji elektrike në bazë të Ligjit të Obiliqit, që Komunën e Obiliqit, me furnizue 24 orë. Kërkoj nga Kryetari sepse është votue, është zgjedhë me mbrojtë këtë të drejtë edhe në mënyrë ligjore.

Kryetari – Ne e kemi adresue si kërkesë dhe ju mund të vini e ta shihni.

Ajet Berisha – Unë nuk po dyshoj në vullnetin tuaj, por duhet të shihet rezultati, nuk duhet të ketë reduktime dhe duhet të merren masat tjera derisa të binden edhe Qeveria dhe KEDS-i, që në Obiliq duhet të zbatohet ligji, nuk duhet të ndalet rryma. Ju për këtë jeni zgjedhë me u realizue sepse është aspekt ligjor.

Kryesuesja – Angazhimi i Kryetarit z.Xhafer Gashi, nuk ka munguar për këto 8 vite dhe nuk do të mungoj asnjëherë për 4 vitet e ardhshme.

Sami Ahmeti – Duke pasë parasysh se jemi në stinën e dimrit dhe shkollat nuk janë në gjendje shumë të mirë, unë dje isha në vizitë në shkollën e Milloshevës ku dihet se atje nxemja ka probleme serioze. Njëra nga kalldajat që bën nxemjen e shkollës është jofunksionale që nga përrurimi i sallës së sporteve atje dhe drejtori më tregoi se nëse, e kryejmë në muajin janar nxemjet nuk do të funksionojnë dhe do të humben shumë orë mësimore sikurse që janë humbur në vitin e kaluar. Prandaj është mirë me pasë parasysh që të bëhet diçka. Përveç kësaj i kemi 3 furgona, ose kombibusa që bartin nxënësit dhe ata furgona janë në gjendje shumë të keqe. Ata janë kalbë krejtë, unë kam hy brenda dhe kam parë se nxënësve mund të iu hyjë edhe këmba brenda sepse dyshemenë e kanë të kalbur komplet. Unë ju lus që të merrni masa dhe e keni mbështetjen tonë që të ndahen fonde, në mënyrë që ata nxënës të cilët barten me ata furgona të jenë të sigurtë.

Ajet Berisha – Ne kemi parë se Komuna ka ndarë bursa dhe është interesante kur e ka bërë emërimin e dhënies së bursave, kur e ka bërë publikimin e listave e ka bërë me shifra dhe kode. Ata janë fëmijët tonë, nuk ka nevojë me fshehë sepse është aspekt ligjor dhe unë nuk e di se çka keni me fshehë aty. Ju e keni Rregulloren dhe në bazë të saj i keni nda bursat, publikoni emrat. Unë kërkoj që të publikohet në tërësi dhe neve, Kuvendit komunal me na ardhë lista në mënyrë që të shohim se kush ka marrë bursa.

Kryesuesja – Kërkesat tuaja do të adresohen në Drejtoritë përkatëse. Po ashtu ju njoftoj se të gjithë ata të cilët ende nuk i kanë dorëzuar kopjet e letërnjoftimit dhe konfirmimin bankar ta bëjnë dorëzimin e tyre në Zyren e Kuvendit komunal.

Mbledhja përfundoi në ora 11:58'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

